

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE

### LËNDA: EKONOMI

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

- Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletë përgjigje:

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletë përgjigje.

- Për pyetjet me zhvillim dhe arsyetim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	2	7a	7b	7c	8a	8b	11	14a	14b	15	17	19a	19b
Pikët													
Kërkesa	22a	22b	23a	23b	23c	23d	26	30a	30b	31	32	35	
Pikët													

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar


2.....Anëtar

1. Cila nga shprehjet e mëposhtme përbën një problem mikroekonomik?

1 pikë

- A) Studimi i çmimit në tregun e grurit.
- B) Studimi i faktorëve që ndikojnë në normat e interesit.
- C) Studimi i faktorëve që ndikojnë normën natyrore të papunësisë.
- D) Studimi i faktorëve që ndikojnë kërkesën dhe ofertën agregate.

2. Grafiku i mëposhtëm tregon kurbën e mundësive të prodhimit (KMP) në një ekonomi që prodhon dy produkte X dhe Y. Çfarë përfaqëson secili prej kombinimeve A, B dhe C në grafikun më poshtë?



3 pikë

---



---



---

3. Kërkesa e tregut për një mall **nuk** është e ndikuar nga:

1 pikë

- A) numri i blerësve.
- B) të ardhurat e konsumatorëve.
- C) kostot e burimeve prodhuese.
- D) pritjet e konsumatorëve rreth ndryshimeve në çmim.

4. Një rritje e kërkesës për makineri dhe pajisje çon në një rritje të kërkesës për çelik. Në këtë rast mund të themi se:

1 pikë

- A) kërkesa për çelik është e përzier.
- B) kërkesa për çelik është e prejardhur.
- C) makineritë dhe çeliku janë mallra plotësues në konsum.
- D) makineritë dhe çeliku janë mallra zëvendësues në konsum.

5. Sipas Ligjit të Ofertës, në kushte të tjera të pandryshuara, nëse çmimi i biçikletave në treg do të ulej:

1 pikë

- A) oferta për biçikleta do të ulej.
- B) oferta për biçikleta do të rritej.
- C) sasia e ofruar për biçikleta do të rritej.
- D) sasia e ofruar për biçikleta do të ulej.

6. Subvencioni i vendosur mbi produktin bujqësor "Grurë" rritet nga 3 në 5%. Ky subvencion do të shkaktojë:

1 pikë

- A) ulje të ofertës për grurë dhe rritje të çmimit ekuilibër.
- B) rritje të ofertës për grurë dhe ulje të çmimit ekuilibër.
- C) një rritje të kërkesës për grurë dhe ulje të çmimit ekuilibër.
- D) një rritje të kërkesës për grurë dhe rritje të çmimit ekuilibër.

7. Tabela e mëposhtme tregon kërkesën dhe ofertën për biçikleta (në numër biçikletash):

Çmimi (lek)	Sasia e ofruar	Sasia e kërkuar
300	6000	1000
250	5000	2500
200	4000	4000
150	3000	5500
100	2000	7000

a) Sa do të jetë sasia ekuilibër:

**1 pikë**

Sasia ekuilibër: \_\_\_\_\_

b) Pajisja e rrugëve me korsitë të dedikuara për biçikleta ka ndryshuar ndjeshëm kërkesën për biçikleta në masën 2500 biçikleta për çdo nivel të çmimit.

Sa do të jetë çmimi i ri ekuilibër?

**1 pikë**

Çmimi ekuilibër: \_\_\_\_\_

c) Paraqiteni grafikisht këtë situatë duke përcaktuar ekuilibrin fillestar dhe ekuilibrin e ri, pas ndryshimit në pikën (b).

**1 pikë**

8. Krahasoni elasticitetin e ofertës për çdo grup produktesh në secilin prej rasteve (a) dhe (b):

a) Oferta për apartamente të reja në një periudhë 3 mujore kundrejt ofertës për apartamente të reja në një periudhë 3 vjeçare:

**1 pikë**

---



---

b) Oferta për prodhimin e karrigeve kundrejt ofertës për prodhimin e portokalleve:

**1 pikë**

---



---

9. Eni është student në Fakultetin e Ekonomisë. Familja e tij përbëhet nga dy prindërit dhe gjyshja. Në tabelën e mëposhtme janë renditur zërat e buxhetit të familjes së Enit për një muaj. Cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë? **1 pikë**

Zërat e Buxhetit	Shuma faktike (në lek)
Të ardhura nga paga mujore e prindërve	150.000
Pensioni mujor i gjyshes	17.000
Shpenzime: Energji elektrike, Ujë	10.000
Shpenzime: Telefon, Internet	30.000
Bursa mujore e Enit	13.000
Shpenzime Ushqime	60.000
Shpenzime Veshmbathje	30.000
Shpenzime Argëtim	10.000

- A) Shpenzimet e domosdoshme janë 10.000 lekë dhe kursimi mujor është 180.000 lekë.  
 B) Shpenzimet e domosdoshme janë 100.000 lekë dhe kursimi mujor është 40.000 lekë.  
 C) Shpenzimet e domosdoshme janë 130.000 lekë dhe kursimi mujor është 40.000 lekë.  
 D) Shpenzimet e domosdoshme janë 100.000 lekë dhe kursimi mujor është 150.000 lekë.

10. Nëse normat e interesave bankarë që paguajnë bankat për depozituesit do të rriten, atëherë njerëzit do të nxiten të: **1 pikë**

- A) rrisin konsumin e tanishëm.  
 B) mos ndryshojnë prirjen e tyre për kursim.  
 C) kursejnë më shumë duke i depozituar paratë në llogari kursimi.  
 D) kursejnë më pak duke i tërhequr paratë nga llogaritë e kursimit.

11. Edhe pse Korporatat janë forma më të rralla të organizimit të biznesit, ato mbeten kontribuesit kryesorë nga pikëpamja ekonomike, krahasuar me firmat individuale dhe me ortakë.

Renditni dy përparësi dhe dy të meta që Korporatat kanë në krahasim me format e tjera të organizimit të biznesit. **4 pikë**

Përparësi: \_\_\_\_\_

Përparësi: \_\_\_\_\_

Të meta: \_\_\_\_\_

Të meta: \_\_\_\_\_

12. Përcaktoni se cila nga alternativat e mëposhtme përbën një burim financiar të brendshëm të firmës: **1 pikë**

- A) shitja e obligacioneve nga ana e firmës.  
 B) shitja e aksioneve në bursë nga ana e firmës.  
 C) marrja e kredive ose huave bankare afatshurtra dhe afatgjata.  
 D) përdorimi i fondit të amortizimit që nuk është përdorur për zëvendësimin e makinerive.

13. Shpenzimet që bën firma për normën e interesit për kredinë e marrë në një periudhë afatshkurtër e cila nuk ndryshon kur ndryshon niveli i prodhimit e fusim në: **1 pikë**

- A) kosto oportune
- B) kosto fikse
- C) kosto kontabile
- D) kosto e ndryshueshme

14. Një firmë vepron në kushtet e konkurrencës së plotë në tregun e grurit dhe e shet produktin me çmimin  $p=60\text{lek/kg}$ . Kostoja totale fikse është  $TFC=100\text{ lek}$ . Vlerat e koston totale variabël për çdo nivel prodhimi paraqiten në tabelë: **2 pikë**

Q	1	2	3	4	5	6
TVC (lek)	40	50	80	120	180	260

a) Sa është kosto totale (e përgjithshme) për nivelin e prodhimit  $Q=3$  njësi?

\_\_\_\_\_

b) Sa është fitimi i firmës për nivelin e prodhimit  $Q=3$  njësi?

\_\_\_\_\_

15. Identifikoni dy mënyra se si firmat në konkurrencën monopolistike realizojnë diferencimin e produktit. **2 pikë**

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

16. Në shpenzimet korrente të qeverisë përfshihen: **1 pikë**

- A) shpenzime për ndërtimin e shkollave.
- B) shpenzime për ndërtimin e rrugëve të reja.
- C) shpenzime për ndërtimin e tunelit të Krrabës.
- D) pagat e punonjësve të administratës publike.

17. Identifikoni dy arsye pse qeveria vendos taksa: **2 pikë**

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

18. Lëshimi i gazrave nga makinat ndot ajrin dhe dëmton shëndetin e njerëzve. Qeveria po merr masa ta zgjidhë këtë problem duke vendosur standarde të çlirimit të gazrave dhe standarde lidhur me vjetërsinë e makinave. Në këtë rast mund të themi se qeveria po ushtron funksionin e: **1 pikë**

- A) stabilizimit të ekonomisë.
- B) ofrimit të së mirës publike.
- C) trajtimit të ekstrenaliteteve.
- D) mbrojtjen e konsumatorëve.

19. Sistemi Bankar në Shqipëri është i organizuar në dy nivele: Banka të nivelit të dytë dhe një Bankë Qendrore.

a) Cili është qëllimi kryesor i Bankës Qendrore në Shqipëri? 1 pikë

\_\_\_\_\_

b) Identifikoni dy funksione të Bankës Qendrore lidhur me (a) ofertën monetare dhe (b) Bankat e nivelit të dytë: 2 pikë

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

20. Cili nga veprimet e mëposhtme do të përfshihet në llogaritjen e GDP të vitit korrent: 1 pikë

- A) Edi i fal librin e matematikës shokut të tij.
- B) Ani blen një kopje të re të librit të matematikës.
- C) Klea blen një kopje të përdorur të librit të matematikës.
- D) Bora shet librin e matematikës që kishte blerë një vit më parë.

21. Gjatë fazës së recesionit të një cikli biznesi ndodh: 1 pikë

- A) Punëzënia fillon të ulet.
- B) Rritje e shpenzimeve për konsum.
- C) Rritje e prodhimit nga ana e firmave.
- D) Rritje e shpenzimeve për lëndë të parë nga firmat.

22. Identifikoni se cilën formë të papunësisë përfaqëson secili nga rastet e mëposhtme:

a) Kompania "Star" shkurton personelin me 100 vende pune si pasojë e krizës ekonomike shkaktuar nga COVID-19. 1 pikë

\_\_\_\_\_

b) Me ndryshimin e regjimit në fillim të viteve '90 në Shqipëri, punëtorët e industrisë metalurgjike nuk gjetën mundësi punësimi në profesionin e tyre. 1 pikë

\_\_\_\_\_

23. Niveli i çmimeve të vitit aktual është 132 dhe niveli i çmimeve një vit më parë 125.

a) Llogarisni normën e inflacionit në vitin aktual, shprehur në përqindje. 1 pikë

\_\_\_\_\_

b) Identifikoni llojin e inflacionit në bazë të vlerës së gjetur në pikën a. 1 pikë

\_\_\_\_\_

c) Supozojmë se niveli i çmimeve në vitin aktual është 120 ndërsa niveli i çmimeve një vit më parë mbetet 125. Llogarisni normën e re të inflacionit, shprehur në përqindje. 1 pikë

\_\_\_\_\_

d) Identifikoni llojin e inflacionit në bazë të vlerës së gjetur dhe shenjës së saj në pikën c. 1 pikë

\_\_\_\_\_

24. Në vitin 1996 në Shqipëri, rritja e shpenzimeve qeveritare rriti fuqinë blerëse të shqiptarëve. Në kushtet kur industria nuk ishte në gjendje të përballonte këtë rritje të kërkesës, pati një rritje të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Në këtë rast kemi të bëjmë me inflacion të shkaktuar nga: **1 pikë**

- A) kërkesa nga rritja.
- B) spiralja pagë-çmim.
- C) spiralja çmim-pagë.
- D) rritja e kostove të lëndëve të para.

25. Nëse ekonomia operon në kushtet e punëzënies së plotë, atëherë norma e papunësisë për këtë ekonomi është: **1 pikë**

- A) zero.
- B) e barabartë me normën e papunësisë ciklike.
- C) e barabartë me normën natyrore të papunësisë.
- D) e barabartë me normën e papunësisë ciklike plus friksionale.

26. Shpjegoni shkurt dy instrumenta të Politikave Fiskale me anë të të cilave qeveria synon të stimulojë aktivitetin ekonomik. **2 pikë**

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

27. Një tarifë e vendosur mbi importin e mallit X, synon të: **1 pikë**

- A) rrisë importin e mallit.
- B) ulë të ardhurat e qeverisë.
- C) mbrojë prodhuesin vendas.
- D) ulë çmimin e mallit të importuar.

28. Monedhat shiten dhe blihen në tregjet valutore që quhen: **1 pikë**

- A) çmim tavan.
- B) kurs këmbimi.
- C) normë interesi.
- D) normë rifinancimi.

29. Kur një grup punonjësish vendosin të pezullojnë në mënyrë kolektive punën, derisa kërkesat e tyre lidhur me pagën dhe kushtet e punës të përmbushen, atëherë themi se kemi të bëjmë me një organizim të quajtur: **1 pikë**

- A) biznes fitimprurës.
- B) sipërmarrje sociale.
- C) grevë e punëtorëve.
- D) sindikatë punëtorësh.

30. "Një biznes ka detyrimin të kontribuojë për komunitetin dhe për shoqërinë, përtej produkteve apo shërbimit që ai ofron".

a) Identifikoni llojin e detyrimit që ka biznesi bazuar në shprehjen e mësipërme. **1 pikë**

\_\_\_\_\_

- b) Listoni dy teoritë përkatëse që shërbejnë në ndihmë të biznesit për përmbushjen e këtyre detyrimeve. **2 pikë**
1. \_\_\_\_\_
  2. \_\_\_\_\_
31. Përkufizoni termin "Buxhet" dhe identifikoni dy parimet mbi të cilat mbështetet sekreti për buxhetim të suksesshëm: **3 pikë**
- Buxhet: \_\_\_\_\_
- Parimi 1: \_\_\_\_\_
- Parimi 2: \_\_\_\_\_
32. Mirela dhe Olta po përgatisnin një manual procedurash për kompaninë ku janë të punësuar me qëllim që të arrijnë zgjidhjet më të mira të mundshme. Ato dëgjojnë me vëmendje mendimet dhe pranojnë kontributet e njëra-tjetrës. Së bashku përcaktuan objektivat e manualit, vendosën mbi temat kryesore që manuali duhet të përmbajë si dhe përcaktuan çfarë njohurish shtesë nevojiten. Bazuar në këtë shembull, rendisni dy elementët kryesorë që Mirela dhe Olta po përdorin për të pasur sukses në punën e tyre (Aftësia për sukses): **2 pikë**
1. \_\_\_\_\_
  2. \_\_\_\_\_
33. Ana punonte në një kompani të pasurive të paluajtshme. Si drejtuese e grupit të punës për identifikimin e klientëve potencialë është e shqetësuar pasi ka konstatuar se niveli i bashkëpunimit midis anëtarëve të grupit është i ulët. Ajo ka identifikuar zhvillimin e një situatë konfliktuale në grup dhe po mendon rreth mundësive për të shuar konfliktin. Cila është aftësia për sukses që po përdor Ana në këtë rast? **1 pikë**
- A) udhëzoi të tjerët.
  - B) përkrah dhe ndikoi.
  - C) mësoj përmes kërkimit.
  - D) zgjidh dhe negocioj konfliktin.
34. Krijimi i një produkti apo shërbimi të ri ose përmirësimi i një produkti apo shërbimi ekzistues quhet: **1 pikë**
- A) tregu i duhur.
  - B) plan i biznesit.
  - C) zhvillim i produktit.
  - D) marketim i produktit.
35. Identifikoni tre hapat e parë që një biznes i ri duhet të ndjekë për një sipërmarrje të suksesshme. **3 pikë**
1. \_\_\_\_\_
  2. \_\_\_\_\_
  3. \_\_\_\_\_